

# DO TA SHKULIM DROGËN NGA RRËNJËT

Nga Gentjan Ruko  
"Koha Jonë", 1 shkurt 2001

Bëhet gati superaksioni. Nuk dihet nëse do mbarojë me ekzekutime të disa bimëve, apo me kapje të kokave të trafikut?

## Shala: Do ta shkulum drogën nga rrënjët

**FIER** - Vjen epoka e ferrit për trafikantët e drogës. Kështu të paktën deklaroi drejtori i policisë së Qarkut të Fierit, Xhavit Shala, i cili njoftoi dje për një operacion dërrmues që do të fillojë në muajin shkurt. Ai theksoi se është hera e parë që do të kryhet një operacion i përmasave të tilla, ku do të angazhohen ndërkohë edhe strukturat e pushtetit lokal.

Në një konferencë shtypi të posaçme, kolonel Shala shpalli një plan të ri strategjik. Ai nënvizoi se policia do të mësyjë me të gjithë forcën e saj, sidomos mbi organizatorët e trafikut. Rrethi i Fierit është nga më të dalluarit në vend për kultivimin e hashashit.

Paralelisht me uniformat blu, kryepletqë e fshatrave do të mbledhin banorët dhe do t'u sqarojnë se masat e rrepta ligjore do të veprojnë nëse vazhdojnë kultivimin e "cannabis sativa".

Drejtori Shala e shpjegoi mesazhin fare qartë: "Ajo periudhë mori fund! Tani e tutje bëni kujdes!" Drejtori tha se policia do të forcojë bashkëpunimin e saj me organet e drejtësisë, për të ashpërsuar politikat penale ndaj organizatorëve të trafikut.

Krahas masave ndëshkimore, do të synohet ndërgjegjësimi i fshatarëve që mbjellin hashash. Do të shpërndahen fletë palosje, do të transmetohen emisione televizive të veçanta dhe spote publicitare, ndërkohë që në shkollat e fshatrave ku kultivohet drogë, do të kryhen seminare për pasojat e helmit. Shala nënvizoi se është e domosdoshme që shteti të zbatojë programe zhvillimi të posaçme në zonat fshatare të prekura nga femomeni si dhe të ndihmojë me kredi banorët.

## Analiza

Drejtori i policisë së qarkut të Fierit kritikoi qeverinë e mëparëshme se "strategjia e ndjekur nuk ka dhënë rezultatet e duhura, kjo edhe për faktin e moskoordinimit të mirë të punës midis strukturave shtetërore dhe atyre të specializuara dhe trajtimit të këtij fenomeni jo me vëmendjen e duhur".

Ish-drejtori i policisë kriminale në Ministrinë e Rendit Publik, Shala, pohoi se ka qenë një fenomen shqetësues për vite të tëra, në qarkun e Fierit, kultivimi i

bimëve narkotike. "Shqetësimi konsiston në masivitetin dhe në inkriminimin e një numri të madh njerëzish, banorë të këtij qarku".

Rasti i parë i kultivimit të cannabis sativa është konstatuar në vitin '93, në komunën e Bishanit. Ndërsa në vitin '95, kultivimi i hashashit mori "përmasa alarmante, duke u shtrirë pothuaj në të gjithë fshatrat e qarkut të Fierit".

Po kështu, edhe në vitin '96 kjo për pasojë të strategjisë së gabuar të ndjekur në këto vite për të luftuar këtë fenomen", nënvizoi Shala.

Më pas drejtori tha se në vitin '97 situata nuk ndryshoi, sepse problemet që policia kishte gjatë atij viti, nuk i dhanë asaj mundësinë për të përpunuar një strategji rezultative.

Në vitin '98, me krijimin e strukturave të specializuara antidrogë, rezultatet ishin më të mira: u asgjësuan 21 586 rrënjë cannabis sativa (nga 62 742 rrënjë të asgjësuar në shkallë vendi. Pra, 33% e sipërfaqes së asgjësuar i përket Fierit). 110 persona u ndoqën penalisht.

Në vitin '99 u asgjësuan 68 641 rrënjë hashashi (nga 91 496 rrënjë të asgjësuar në shkallë republike, ose 75% e sipërfaqes së asgjësuar i përket Fierit). 126 persona iu dërguan prokurorisë.

Në vitin 2000 në komunën e Cakranit dhe në atë të Ruzhdies, fenomeni kishte përmasa jashtëzakonisht të mëdha. Vetëm në këto dy komuna u asgjësuan 52 905 rrënjë hashashi, ose 20% e numrit të rrënjëve të asgjësuar në shkallë republike. Mirëpo në shumë raste, policia nuk arrinte të kapte kultivuesit në fshatra gjatë kontrolleve të banesës. Dhe inkursionet e forcave të rendit merreshin në fund të stinës së verës, kur bima pijej.

Xhavit Shala e hodhi poshtë dje këtë taktikë, ndërsa deklaroi se "policët nuk do të jenë më bujq që korrin hashash, por ata do të godasin që në mbjelljen e bimës".